



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **24.01.2018 (e Enjte)**, në Zyrën e Drejtorit të Administratës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së, znj.Ibadete Hyseni (zyrtare për barazi gjinore). Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Uroj që të kemi një vit të mbarë.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje kryesues dhe ju të nderuar të pranishëm! Kam një pyetje lidhur me seancën e fundit të takimit të KPF-së që e kemi pas. Zakonisht, Zyra për Informim i qet informimet në uep faq të komunës, që ajo se çka ka ndodh në takim të komitetit, d.m.th takimin e fundi Zyra e Informimit nuk e ka dhënë hiq këtë informatë, ndoshta pse nuk ka kalu asnjë pikë ose që e keni blloku ju apo pse kjo ka ndodh. Kjo është një përgjegjësi e jotja kryesues, se je kryesues i Kuvendit dhe i KPF-së, pse nuk u dha informatë për mos mbledhjen e takimit të fundit. Kjo tregon që transparenca është e nivelit më të ultë, vetëm aty ku është diçka që ju shkon për shtati e jepni informatën. Zyra e Informimit e komuna nuk është e LDK-së e as e grupeve të caktuara të njerëzve, po komuna është e të gjithë qytetarëve dhe gjithçka çka ndodhë duhet të njoftohen. Kjo është si vërejtje shume serioze që e japim ne.

Kryesuesi z.Naim Pira: Sinqerisht unë nuk interferoj asnjëherë sa i përket Zyrës së Informimit, që me qit apo me hek diçka. Ju betohem që unë as që e kam përcjell uep faqen, nuk e di sa me besoni, kjo është vërejtje me vend që e bëni ju Bekim.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje për kryesuesin dhe për ju të pranishëm! Kjo kritik është e shnoshë dhe është për të mirë të qytetarëve, por Bekim edhe unë po ta thamë me një bindje të plotë, unë e çmoj shumë si zyrtar Mustafën, se është shume qe i rri gati këtyre seneve. Nuk e kam përcjell unë për këtë qe e thua ti, unë të falënderoj që po e jep këtë informacion ti, pavarësisht ngjarja se si ka ndodhë, opinionin apo qytetaret e Vitisë kanë qenë dashur me ditë mu informu për këtë.

z.Mustaf Mehmeti, zyrtar nga Zyra për Informim: Përshëndetje për të gjithë! Në atë takim, unë nuk kam qenë në cilësinë e zyrtarit për Informim për të raportuar lajmin, sepse atë mbledhje i kam pas dy pika të rendit të ditës, po megjithatë, pasi që nuk është mbajtur takimi, ka deshtu, na nuk e kemi pasqyru, nuk e kemi pa të arsyeshme ta pasqyrojmë që një takim i cili nuk është mbajtur fare dhe nuk është marr asnjë vendim, për të cilën është thirr KPF-ja. Ndoshta është një gabim, leshim teknik si i tillë, kërkoj falje dhe herave tjetra do të lëshojmë informatë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Momentin që thirret mbledhja nga ana e kryesuesit të Kuvendit dhe kur të nënshkruajnë anëtarët e KPF-së, tani a kalojnë apo nuk kalojnë pikat, është çështja e këtyre anëtareve, informacioni duhet mu dhënë. Po ju them edhe njëherë për ju të gjithë, nëse hasni prapë në kësi probleme, më informoni me kohë mua, unë do t'i eliminoj këto.

z.Bekim Azizi: Unë nuk ceka emër, po thash Zyra e Informimit që jep informata. Për mu sa më rëndësi se kush, cili e shkrun, po me rëndësi, që informata ka qenë të del prej Zyrës së Informimit. Informata duhet me u dhënë herëve tjera ne si opozitë e kemi marr këtë si shqetësim, pasi që konsiderojmë që u kanë politikisht, pasi që e keni marr si dështim që nuk ka kalu asnjë pikë dhe e keni meshef si informatë, kjo ka qenë ajo shqetësimi.

Kryesuesi z.Naim Pira: Nëse nuk ka dikush tjetër ndonjë pyetje, atëherë për këtë mbledhje kemi paraparë këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2018
3. Shqyrtimi i planit vjetor 2019 dhe plani strategjik 2019 i njesisë së Auditimi të brendshëm në Komunën e Vitisë.
4. Informat nga zyra e prokurimit mbi raportin e prokurimit dhe planifikimi final i prokurimit për vitin 2019.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit nr. 01-410/03-538 të datës 05.06.2018 për formimin e komiteteve konsultative.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjeve të takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bashkëpunimin ndërkomunal të qëndrueshme me Komunën e Kirrhain.
8. Draft Plani i punës për vitin 2019 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
9. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për vitin 2018.

A ka dikush rreth rendit të ditës?

z.Bekim Azizi: Nuk e di a kish pas vend të mendohet për seancë të sjellët kjo pika e Drejtorisë së Kulturës për pjesën e shoqërisë. Në parim ja kemi pas dhënë një afat dymujor shoqërisë për me bë një zgjidhje të problemeve që i kanë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Bekim, në këtë seancë do të na vjen edhe informata e kryetarit dhe do të kemi një seancë që do të jetë e stërzgatur, sepse i kemi edhe pasqyrat. E lusim drejtorin, që këtë temë ta diskutojmë në seancën tjetër.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë po mendoj që bënë me lanë për muajin Shkurt. E kemi pas një takim dje me ata, ku kam qenë unë në takim, kryesuesi dhe kryetari. Jemi dal me propozimet e tona, se ne rast që nuk arrin që pa ndërhyrje të askujt me arrit që ata me vazhdu punën, nëse nuk arrin ata ne duhet me dal me propozim që te heket 25%. Unë po propozoj, që këtë afat të ja japim deri ne seancën e Shkurtit.

z.Bekim Azizi: Okej, edhe unë po pajtohem, që deri ne seancën e shkurtit të kem afat ata dhe ta përfundojmë këtë. Tani po lidhem të pikat e rendit të ditës që u propozun nga kryesuesi, pasi që është edhe informata e kryetarit ne kuvend, unë kërkoj që kësaj radhe me e hek piken e pasqyrave financiare për këtë seancë, që mos me shti në rend dite me arsyetim që na zakonisht kemi të bëjmë, që kur ta miratomi buxhetin të pikat që janë të përgjithshme, asfaltimi i rrugëve rurale dhe tashti këtu kemi pika të caktuara ose ndërtim të treturave dhe ndriçim publik. Remnik, Sadovinë, Tërstenik, Ramjan, përmenden 20 fshatrat. Prapë e kemi të njëjtën, përmenden 5-6 fshatra, e ki asfaltimi i rrugëve ne dy tri vende, përmenden nga 7-10 fshatra. Tash unë e shof, që një që ma ka pru drejtori me herët, cilët kanë

mu asfaltu. Unë mendoj që kjo duhet të jetë për seancën tjetër dhe të kompletohet me e be, që me i nxjerr rrugët krejt nga një nga një. Sa ka pas qajo rrugë hapësirë, sa ka kushtu, masi që është raport vjetor, sepse mu pas kanë tremujor nuk kisha hi detalisht edhe me naj pru edhe një kartelë analitike të shpenzimeve komplet për çdo kod buxhetor, shpenzimet që janë bë. Unë kërkoj që kjo pikë, pasqyrat financiare të hekën në këtë seancë të kompletohet për seancën tjetër.

Kryesuesi z.Naim Pira: Bekim, neve nuk na qet telashe me hek si pasqyra financiare, sepse ne prapë duhet me e adresu këtë, mirëpo për shkak se vitet e kaluara MAPL-ja dhe organizatat e ndryshme na kanë dhënë vërejtje, pse nuk i diskutojmë ne pasqyrat financiare në seancën e parë të janarit, për shkak të performances 15 ditëshin e fundit të janarit dhe, unë po thamë, të drejtën edhe pse kanë kërku nga unë drejtorja, që të jetë kjo për muajin e dytë, unë e kam bë presion që të përgatiten dhe të debatohet në seancën e parë të kuvendit dhe për shkak të performaces po në muaj që këtë materialin shtesë që po e kërkon ti, me e obligu Drejtorinë e Financave, t'i sjell të gjitha dokumentacionet që i kërkon ti në seancë dhe mun që t'i diskutojmë aty, krejt është çështje e performances.

z.Bekim Azizi: Parimisht ti për performancë të mirë e ki pru këtë, po ne si KPF po e kërkojmë që qekjo mu plotësu me qeto që u desh, sepse ka kogjo shume material. E kemi edhe informatën e kryetarit, janë kogjo shumë për një seancë, për mu është e arsyeshme qe kjo pikë mu shty në seancën tjetër. Ju në seancën e fundit e pat edhe atë pikën që ke për transparencë, po që kësaj here nuk e ke sjell hiq.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pikën e cila ka qenë seancën e kaluar për transparencën, ajo ka qenë që të debatohet vitin 2018 për periudhën 2017, dhe tash ajo çështje më ka përfundu dhe nuk e ka logjiken me ardh tash me diskutu 2019 për 2017. Nuk e marrin ma përformancë ne për atë pikë që nuk e kemi debatu, kemi me marr minus pikë.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasqyrat financiare bazë ligjit janë 30 dite, pas mbarimit të vitit fiskal kemi të drejt me i pas të përgatitura, d.m.th me 31 Janar Drejtorja për Financa duhet me bë raportin, se kur organizohet mbledhja është problem i kuvendit komunal, por për hirë të vërejtjeve që naj ka dhënë MAPL-ja, OSBE, se me bë në janar raportimi e pasqyrave financiare edhe vitin e kaluar e kemi mbajt në janar dhe këtë vit kemi mendu me zënë janarin. Ajo çka është më kryesore, edhe pse thotë që 31 janari është i fundit, ne shënimet i kemi të kompletuara, kemi bë përpjekje edhe fizikisht kemi shku në nivelin qendror i kemi marr shënimet si pasqyra. Nuk kemi mangush asgjë, për këtë aspekt nuk ka nevojë me shty, a ndërsa për tjera aspekte, ju KPF-ja vendosni kur ta keni dëshirën. Te shpenzimet kapitale, ju e dini që projektet janë dyvjeçare dhe pasqyrat mundet një pjesë e projektit që është pagu, që është kry mu pasqyru këtu, d.m.th nuk shihet krejt si projekt, sepse fillon 2018-2019. Ju mundeni me kërku një raport special për kodin e shpenzimeve kapitale, mundeni me thanë, asfaltimi i rrugëve rurale. Po jo krejt, sepse është shumë ngarkesë e madhe, po dikun ku keni interes ju me pa pasqyrën e drejtë, unë e nxerri analitiken, jav bij, është e pasqyrave financiare të bashkangjitur me pasqyra financiare ose edhe si dokument të veçantë, se këtu është e pamundur me parapa, se është projekt dyvjeçar, fillon 2018, përfundon në 2019. Tash mundet me qenë kur janë bë pagesat, ne pagesat i bëjmë ashtu qysh kryhet punët.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Vërejte nuk është hera e parë që e bëjmë këtë vërejtje, kemi bë edhe në raportin financiar gjashtëmujorë, këto vërejtje janë kanë të njëjta, i përmendi Bekimi. Na kërkojmë që p.sh. në fshatin Beguncë janë shtru 200 metra asfalt, në Remnik 500 metra, tash 57 mijë euro janë shtru ne 10 rrugë ose trotuare dhe ndriçime publike. Janë aty këtu me i cek edhe unë jam me pas raport shtesë për to, edhe të meremetimi i shkollave, cilat janë merimetu, çka është punu, edhe unë jam për mos me kalu kjo pikë për shkak të kësaj.

z.Jakup Demiri: Te problemi i shoqërisë kulturore artistike, që është në Viti. Nëse e shtymë për muajin shkurt, është problem, se tani e kemi muajin Mars e nuk e di sa kemi kohë, afate, sepse e kemi "Flakadanin e Karadakut", i kemi festat në Komunën e Vitisë, edhe unë jam që ata me zgjidh problemin, mirëpo nëse nuk e kanë zgjidh deri me tani, pak ka gjasa që ata me zgjidh deri në shkurt. Te pika e dytë, kemi pas vërejtje edhe me herët, që ka x probleme që duhet mu zgjedh, janë këto 57 mije euro, janë të përfshira 15 fshatra me ndërtim të trotuarit dhe ndriçimi publik ne Komunën e Vitisë.

z.Bekim Azizi: Propozimi im ka me qit në miratim, që, a jemi me hek këtë pike nga rendi i ditës, e unë kërkoj nga drejtori që nëse nuk hynë në rend dite kjo pika e dytë, që këto projektet çka janë të

përgjithshme, se këtu e kemi problemin, që edhe kur po e miratojmë buxhetin që na nuk po kemi qasje aty, ato raporte që mi ka pru mu drejtori, që në 2018 kanë mu kry, nuk janë kry ato rruga që mi ka sjellë mu, që 2018 kanë mu shtru, nuk janë shtru, le t'i nxjerr qato ndriçime edhe kontratat me vepër, kush ka kontratë, të gjitha këto shtesa për seancën e ardhshme.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po ju lus edhe njëherë, që ta kalojmë këtë pikë, e drejtori i Drejtorisë së Financave naj sjellë materialet e kërkuara nga anëtarët e KPF-së. Unë e qes në votim kërkesën e Bekimit, që pika e dytë e rendit të ditës, pasqyrat financiare, të tërhiqet nga rendi i ditës. Kush është pro kërkesës së Bekimit, kush është që të kalon kjo pikë? Me 4 vota kundër dhe 3 pro, nuk kalon dmth pasqyrat financiare hekën nga rendi i ditës për këtë seancë. Tani qes në votim miratimin e rendit të ditës pa piken e dytë, e cila u terhek. Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës. Nga të gjithë të pranishmit u miratua procesverbali.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

2. Shqyrtimi i planit vjetor 2019 dhe plani strategjik 2019 i njësisë së Auditimit të brendshëm në Komunën e Vitisë

Drejtori i zyres së Auditimit z.Fevzi Mehmeti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Duke u bazuar në ligjin Nr.06L.021 për Kontrollin e Financave Publike, drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, është i obliguar për çdo vit të hartoj planin strategjik të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për trevjeçar dhe planin vjetor për vitin 2019. Ky plan apo ky obligim i joni, është të hartoj dhe të propozoj kryetarit të komunës dhe KPF-së për miratim, diçka qe kjo ka ndodhe dhe është hartu dhe është miratu edhe nga ana e Komitetit për Auditim dhe nga ana e kryetarit të Komunës, ku nga një kopje i është dorëzuar kryetarit të komunës, Komitetit të Auditimi dhe një kopje e parashtruar i është dorëzuar Ministrisë së Financave apo drejtorit të Njësisë së Auditimit Qendror, prandaj duke u bazuar në planin strategjik para se mu hartu, ne kemi bë përgatitjet duke i pas parasysht obligimet e tona ligjore, ku me kohë i kemi dërgu të gjithë drejtorëve të drejtorive një shkresë, ku kemi kërkuar, se cilat fusha secili drejtor i drejtorisë do ti mbulon me Njësinë e Auditimit. Materialin e keni pranuar me kohë, unë jam në dispozicionin e juaj, për pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm.

z.Ekrem Abazi: Isha duke pyetur, a je auditor i pavarur, e di se je në varësi të kryetarit, por punën që e kryen, a je i pavarur apo je vetëm një argat i kryetarit? E dyta, drejtorëve ju thua ku me të aditua. Ti duhesh me shkua me auditua pa e ditë drejtori hiq, edhe e rrezikut të lartë çka është ajo.

Drejtori i zyres së Auditimit z.Fevzi Mehmeti: Unë mendoj se duheni me kërkuar ndoshta ndonjë trajnim apo seminar nga Ministria e Financave. Të njoftohet menaxhamenti me rolin e Auditimit të Brendshëm. Na nuk jemi inspeksion. Auditori i Brendshëm është këshilltar apo këshillëdhënës i menaxhementit, d.m.th çdo gjë që shkon keq, që nuk i përmbush objektivat, Auditori i Brendshëm është krahu i djathtë me i ndihmu, me i përmbush obligimet. Tash te shpenzimet, na punojna me metodën e monstrave, na mundemi mi marr 100 raste prej qatyre, mund të jen 10 mijë raste, na në bazë të atyre mostrave e shohim se diçka nuk është duke funksionuar. E jonja eshte me dhënë rekomandime dhe me i shiqu, se apo i zbaton ato menaxhmenti. Nëse menaxhementit ja qojmë raportin dhe nuk pajtohet, ka të drejtë me dhënë komentet e tyre. Ato komente nëse kanë bazë, na e përmirësojmë, për ata kanë 15 ditë kohë me dhënë arsye kur të ja dërgojmë ne raportin. Nëse nuk jep komente, d.m.th qëndrojmë ne mes saj. Secila njësi, apo secili drejtor, është i obliguar ligjërisht t'i zbatoj rekomandimet, sepse janë në dobi të organizatës buxhetore.

z.Ekrem Abazi: Sa rekomandime ki dhënë gjatë këtij viti dhe sa i kanë zbatu.

Drejtori i Zyrës së Auditimit z.Fevzi Mehmeti: Ne nuk jemi tu bisedu për raport, po për planin. Mu kanë të ishmi tu bisedu për raport, unë i kisha tregu për rekomandime, sa janë zbatu, ku janë dhënë

për çka janë dhënë. Nëse ju e bëni rend dite, që me raportu për raportin e auditorit, unë jam i gatshëm, e raportoj si që e kam bë raportin vjetor.

z.Ekrem Abazi: Ti e ki një pagë të mirë, sepse është me peshë, e tash na auditor nuk jemi krejt. Unë muj me pyet çka mu ma marr mendja, ti mundesh mu përgjigj apo mos mu përgjigj.

z.Jakup Demiri: Auditimi është një pararojë e punëve që kryhen. Po ishalla e bëjnë punën me sinqeritet e mirë. Edhe ne kërkojmë nga ju, që kur të kemi kërkesa, shënime, me qenë më të shpejta, me naj ofru.

z.Ekrem Abazi: Auditori i Jashtëm i ka dhënë shumë rekomandime Komunës së Vitisë, atëherë të koka edhe faji yt, edhe këta drejtorat që nuk kanë dhënë vërejtje.

Drejtori i Zyres se Auditimit z.Fevzi Mehmeti: As Auditori i Jashtëm, as ai i brendshëm nuk e administron asnjë zyrtar civil, asnjë menaxhment të lartë. Nëse ai bën shkelje, edhe nëse shkon tek përgjegjësia, unë e thash, auditori jep opinion të kënaqshëm edhe Auditori i Jashtëm edhe ai i brendshëm, unë i shikoj, p.sh. janë 10% e fushës që i mbuloj, 90% mundet mu kanë krejt ndoshta mundet me pas edhe vepër penale brenda, po se kam auditu për atë arsye, se mbaj përgjegjësinë, sepse shkoj me metodën e mostrave. Ligji ma lejon, që qato mostra që i kam marr, qato gjendje që e kame marr, unë kam ardh të një opinion dhe të gjeturat, p.sh. janë dhënë dikun 25 rekomandime nga njësia e jem, janë dhënë këtë vite për komunën. Mu nuk me intereson sa i jep Auditori i Jashtëm, unë flas për fushën teme, edhe senet që unë i kam pa.

z.Ekrem Abazi: Qëllimi im final është, që Auditori i Jashtëm mos me dhënë shume rekomandime, sepse unë jam qytetar i kësaj komune, e du këtë komunë me së shumti.

z.Jakup Demiri: Çka ndryshon ky plan nga plani i mëhershëm. Te pika 3.1, detyrat e pazbatuara të vitit të kaluar, kanë mbetur menaxhimi i Personelit, sistemi i pagave.

Drejtori i Zyrës se Auditimit z.Fevzi Mehmeti: Këtë vit e kemi në shtatë fusha, ndërsa tetëmbëdhjetë fusha janë me plan strategjik. Na këtë vit i kemi marr vetëm shtatë. Tash qeto fusha, auditimet me rrezikshmëri të lartë çdo herë për çdo vit auditohen, ndërsa auditimet me rrezikshmëri të mesme çdo dy vite. Këta me rrezikshmëri të vogël, çdo tri vite. Shiko, plani nuk bëhet për një ditë, na mbledhim shënime, aty thotë, edhe sa auditime kanë mbetur pa u krye. Momentin që jam kanë duke e bërë planin, janë mbet edhe ato auditime pa u kry, s'ka përfunduar. Na para se me shkua dikun në auditim, e bëjmë një kërkesë, tri ditë përpara zyrës ku auditohet.

z.Bekim Azizi: Pak e bëre te plani strategjik, the se për këtë vit janë paraparë 10 auditime, këtu na i paraqite 7. Unë mendoj, se në planin strategjik nëse i she 10 auditime, duhet mi planifikua 10. Tani në fund me thanë që s'kam, mund me i kryer tri, për arsye se nuk kam pasur kapacitet të njerëzve. E dyta, sa tu kanë lidh ty gjetjet e tua që i ke pas me raportin e auditorit të jashtëm. E treta, a ke raport të plotë të vitit kalendarik që shkoi? Raportet e auditimit që i ke bërë, me na i paraqit në komitet. Tri seanca e kam kërkuar, që ti me i sjellë në Kuvend, me na raportua, por nuk e kanë sjell këta. Unë mendoj, se një raport të vitit 2018 të punës tënde që e ke bërë, me na i sjellë, që ti me kompletua punën tënde.

Drejtori i Zyrës se Auditimit z.Fevzi Mehmeti: Po se kaq janë kapacitetet e tona. Mundemi me marr edhe një auditor, se na i lejon ligji, a këto i kem cek se kam, mundem me mbërri. Plan vjetor është nxjerr nga plani strategjik, duke pasur parasysh kapacitetet të cilat i kam në dispozicion. Tash kujt i raporton, këtë plan e ka miratuar kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit si organ i pavarur, i cili e monitoron punën e auditimit. Sa i përket raportit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në ligj thotë: “drejtori i Njesisë së Auditimit i raporton kryetarin të Komunës, t'i raporton Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore Harmonizuese” Me kërkesë i jepet raporti auditorit gjeneral gjykatës, por pa e njoftuar kryetarin e komunës ne nuk mundemi t'i japim askujt raport.

z.Bekim Azizi: Na nuk jemi duke e kërkuar një raport, po jemi duke e kërkuar një informatë. Neve na vjen i Auditorit të Jashtëm, që nuk ka qasje as me komunë e nuk na Vjenë një që është pjesë e Komunës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit për kontributin e dhënë.

Si pikë të tret të rendit të ditës kemi:

3. Informatë nga Zyra e Prokurimit mbi raportin e prokurimit dhe planifikimi final i prokurimit për vitin 2019

z.Fadil Abazi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Zyra e Prokurimit ka përgatitur një raport vjetori të kontratave të prokurimeve të zhvilluara në 2018 dhe planin vjetori të prokurimeve për vitin 2019. Materialin e keni të gjithë, gjatë kësaj periudhe të vitit 2018, Zyra e Prokurimit, ka zhvilluar 67 aktivitete të prokurimit prej të cilave aktivitete 17 kanë të bëjnë me lëndë shërbimi në 18 aktivitete janë prokurimi pune dhe 32 janë furnizime, të cilat me aktivitete prej këtyre 67 janë me kontrata minimale në vlerë minimale. Prej këtyre aktiviteteve, 63 aktivitete të prokurimit janë përmbyll me procedurë, janë finalizuar me nënshkrim të kontratës, ndërsa 3 aktivitete janë në procedurë e sipër, një aktivitet është në OSHP me ankesë dhe jemi në pritje të marrjes së vendimit nga OSHP, që ka të bëjë me projektim, mirëmbajtje dhe pastrimi i hapësirave gjelbëruese, parqeve dhe varrezave të dëshmorëve në qytetin e Komunës së Vitisë. Gjatë vitit 2018, Zyra e Prokurimit ka lëshuar 1070 urdhërblerja për pagesat të kontraktuara, ndërsa në total shuma e planifikuara e realizuar e kontratave për 2018, së bashku me memorandumet e nënshkuara me ministrinë të ndryshme. Faktikisht shuma e planifikuar është kjo, 4,866,433.47 euro, kurse shuma e kontratave të lidhura është 3,651,064.87 cent. Nëse ka nevojë diçka me shumë për raportin, pasi që materialin e keni marr, unë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Bekim Azizi: Po me intereson tash, n'bazë raportit të Prokurimit, ti zakonisht e planifikon me buxhetin që planifikohet për investime, kontratat 4,866,433.47 të planifikuara, dikun 1 milion e 200 mijë parimisht janë në OSHP ose janë të porealizuara ose në proces. A ki pas gjatë vitit anulim të proceseve, ose me ankesa, që janë kthy prej fillimit, se ato nuk janë të paraqitura këtu. Sa raste i ki pas që të lidhen gjatë vitit, dështim të tenderave ose ankesa që u anul.

z.Fadil Abazi: Anulim të procedurës dhe përsëritje të procedurës nuk kemi asnjë rast që ndodh me vendime të OSHP-së, me pas anulime, mirëpo ne nuk kemi pas, ndërsa ankesa kemi pas, gjithsej 22 ankesa i kemi pas gjatë vitit të kaluar, që janë kanë diçka. Herave tjera i kemi pas nga 2 ose 3 e 5, nuk ka pas më shumë, ndërsa sivjet 11 kanë shku në OSHP, ndërsa 11 janë zgjidh në fazën e parë, sepse shkalla e parë e zgjidhjeve të ankesave është autoriteti kontraktuese, shkalla e dytë është OSHP-ja me ligjin e ri të 2013, prej këtyre 11, vetëm një e kemi në procedurë, të tjerat i kemi zgjidhur kushtimesh. Muj me thanë të gjitha janë kthy në favor të autoritetit, askund nuk kemi dështu.

z.Bekim Azizi: Te planifikimi po me intereson. Kemi shembull raste që e ki parapa me fillu në Janar, a ke fillu me qeto procedura të cilat janë planifiku me fillu para ditës së sodit, a ki mujt me fillu, edhe çka ke shqetësuese sa e pash unë, prej 67 kontratave me duken që kanë 30, kanë të firmave të Komunës së Vitisë. A nuk kanë kapacitete të Vitisë, apo bashkëpunimi është më i lehtë me njerëz të panjohshëm të bëhen këto. Edhe kanjeher i shohë do gjetura, do tendera që jepen, a ki naj farë metre matëse, p.sh. kom ndëgju unë, që kur konkuron dikush për riparim të automjeteve dhe mirëmbajtje, ty ta jep p.sh. gomen e kerrit 1 euro, edhe nëse ta le gomen e kerrit 1 euro dhe ti se ndërron asnjëherë gomat kerrit, edhe bazë asaj ta fiton tenderin. Ki edhe shumë raste të tjera, ku ta jep një paramasë që diçka nuk shkon hiq, a keni ju naj rregullore që kur e dinë krejt dynjaja, që një gomë e kerrit nuk kushton 1 euro, mirëpo ai ta fiton tenderin.

z.Fadil Abazi: Po janë kanë të parapamë tri procedura, me të trijat kam fillu. Është për furnizimi me inventar tek objekti i ri. E kame furnizimin me matrial, dokumentacion që ju duhet QKMF-se në çdo fillim vit, at e kemi shpallë, është në procedurë dhe furnizimi me barna, qeto janë të parapamë. Sa i përket rasteve që i ceku Bekimi, te gomat e kerrit, unë nuk po i disha këto raste.

z.Ekrem Abazi: Data e parashikuar, kur të fillon Zyra e Informimit për një punë me kry, a ka afat kohor, kur fillon edhe kur mbaron, p.sh. rrugët rurale fillojnë prej 25.02 deri kur mundet me shku kjo llogariti edhe ankesat.

z.Fadil Abazi: Ankesat mundem me qen të përsëritshme, ndërsa këto bazë vlerave përafërsish prej vlerës se projektit, janë data të caktuara me ligj se sa zgjat, p.sh. të rrugët rurale ne e kemi vlerën e mesme të punës, ajo duhet të shkoj d.m.th 20 ditë të jetë i hapur projekti, dy dite ja lam KRPP-së për

me i verifiku a jemi konform ligjit, mas dy ose tri dite bëhet shpallja, e mas shpalljes janë 20 ditë. Pastaj e bën hapjen e ofertave, me ligj i ki 30 ditë me vlerësu, ti varet sa e bënë organizimin, mundesh brenda dy dite, neve nuk na ka ndodhë, unë muj me ta dhënë optimal, që brenda 7 dite mesatarisht i krymi të gjitha. Pastaj, nëse arrin të shpallja prej fillimit të procedurës deri mbarim, mundet me shku 6 muaj me shku në OSHP, dy herë kjo të vonon. E nëse gjithçka shkon në rregull, mesatarisht 35-40 dite është një procedurë e vlerës së mesme që më duhet mu me kry.

z.Bekim Azizi: Te realizimi i projekteve, kontratat me punë shtesë ose aneks shtesë, sa ki numër gjatë vitit.

z.Fadil Abazi: Është e cekur në informatë, i kemi dy kontrata pune shtesë për vitin 2018.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë e falënderoj Fadilin.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit nr. 01-410/03-538 të datës 05.06.2018 për formimin e komiteteve konsultative

E kem këtë propozim vendim para komitetit, për shkak se na si komitet dhe si kuvend i kemi formuar dy komitete konsultative, dhe në bazë të udhëzimit administrativ i cili është në fuqi parashihet, se mëditja e tyre për mbajtjen e mbledhjeve duhet të jetë 50 euro e jo 30 euro. Siç e kemi ne, pasi nuk ka për diskutim, kush është që kjo pikë të shkoj në kuvend? Konstatoj se me vota unanime shkon në Kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjeve të takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë

Kjo mund të ketë ndryshime të datave, mirëpo ne duhet ta kemi. A donë dikush të diskutoj rreth kësaj pike ju lutem. Pasi nuk ka për diskutim e hedhim në votim që të shkoj për Kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bashkëpunimin ndërkomunal të qëndrueshme me Komunën e Kirrhain.

Ja kisha dhanë fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari z. Hasan Aliu: Unë nuk do të hapëm shumë, sepse shumica e këshilltareve e dinë se ne e kemi pasur një bashkëpunim me Komunën e Kirchanit. Ajo qa duhet me cekë, se në mesin e gjithë komunave të Kosovës vetëm dy kanë marrëdhënie bashkëpunimi me komunat gjermane, është edhe Mushtishti nga Suhareka. Pikërisht për të unë kam qenë edhe në Beograd, besoj se Komunës së Vitisë i bënë nderë një vendim i tillë. Ju e keni para jush edhe vendosni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

z.Bekim Azizi: Megjithatë bashkëpunimi është ma herët se komuna, është kyç. Në vitin e kaluar në këtë projekt, ndërsa na kemi qenë si fshatë i kyçur para 3 vite, ndërsa kur kanë kuptuar se është fituar projekti, është kyçë komuna. Mirëpo, kyçja e komunës është e mirë, se është bashkëpunim ndërkombëtar, sa do që janë projekte të vogla.

z.Jakup Demiri: Një kërkesë ndaj komunës, bashkëpunimi me Komunën e Kirchamit e di se muaji gusht është pushim edhe atje edhe këtu por vizitat që i bëjnë ata në Viti, vit për vit a ka mundësi me u bë në fund të Korrikut dhe në fillim të gushtit për shkak të pranisë së diasporës në komunën tonë, që me mund me bë edhe një takim njëditor edhe diaspora e Vitisë me ta, besoj se kishte me qenë shumë e nevojshme për disa projekte, që mendoj se na kish ndihmua edhe diaspora edhe ky bashkëpunimi që është ndër komunal.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Po ta jap një informacion pak ma të gjerë, se sa nuk kam qenë në këtë konferencë as unë nuk e kam ditë në tansi, kur kam shkuar aty në konferencën e cila ka qenë e organizuar, e kam pa rëndësinë shumë të veçantë, e kam pa se na duhet me vrapua pas saj, se aty kanë qenë 12 komuna. Të gjitha komunat gjermane, e kanë pasur nga një partner prej Kosovës, kemi qenë

vetëm na, prej Serbie kanë qenë 5 Komuna, prej Bosnje kanë qenë 5 komuna, u dashtë me qenë edhe Suhareka, por për shkak të raporteve, se në Mushtisht paskan qenë do serbë e kështu diçka nuk kanë guxuar me ardh. Aty e kam parë rëndësinë, se kemi pas paraqitje çdo komunë, jam dal unë me gjermanin edhe me Tefikun. Këtë partneritet ne duhet ta vazhdojmë, se na mundemi me fitu vetëm përmes KIrchaimit.

Kryesuesi z.Naim Pira: E hedhi në votim që të shkoj për kuvend kjo pikë e rendit të ditës. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

7. Draft Plani i punës për vitin 2019 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Nënkryetari z.Hasan Aliu; Unë nuk do të ju marr kohë, ju e keni materialin KKSB-në, e themelon kuvendi. S'kisha me shtu diçka ma shumë.

Kryesuesi z.Naim Pira: A donë me diskutua dikush, pasi jo, e hudhi në votim që të shkoj për Kuvend kjo pikë. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të fundit të rendit të ditës:

8. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për vitin 2018

Kuvendi e ka themeluar KPF-në, Komitetin për Komunitete dhe komitetet tjera jo obligative, të cilat kanë qenë dhe dy komitete tjera, Komiteti me Persona me Aftësi të Kufizuara edhe Komiteti për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Vendimmarrje. Tjerat për shkak të mos pagesës nuk kanë qenë aktive.

Mbledhja përfundon në ora: 11:50

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë
z.Naim Pira
